



**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**

Nr. 1573 Prot. Datë 13 . 11 .2019

**Fondacioni Kujto.al**

**Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit**

Nr. 01 Prot. Datë 13 . 11 .2019

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, më datë \_\_\_ tetor 2019, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

**1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH),** përfaqësuar nga znj. Gentiana Sula, Kryetarja e Autoritetit,

dhe

**2. Fondacioni kujto.al – Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit – Tiranë** (i quajtur në vijim **kujto.al**), e përfaqësuar nga znj. Blerina Gjoka, Drejtore.

Palët janë marrë vesh se për të realizuar qëllimin e përbashkët do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje të shprehura më poshtë.

### Neni 1

#### Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në njohjen e së shkuarës, nëpërmjet hapësirave e mundësive për ballafaqim me dosjet dhe historitë e komunizmit, për edukimin e brezave të rinj dhe zhvillimin e dialogut të shëndetshëm shoqëror, në emër të një të ardhmeje më të mirë.

### Neni 2

#### Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimit dhe studimit të dokumenteve e të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit të periudhës 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991 dhe të organeve të diktaturës komuniste.

Bashkëpunimi në fushën e materialeve digjitale, rubrikave mediatike, online, videove sensibilizuese, dëshmime gojore, të botimeve, etj., mbi kujtesën kolektive dhe ndërgjegjësimin për të shkuarën, që hedhin dritë në krimet e diktaturës së proletariatit në Shqipëri dhe periudhën kur ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit.

### Neni 3 Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj Marrëveshjeje është ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017, VKM nr. 93, datë 27.02.2019, “Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Rezoluta nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) dhe Rezoluta “Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (2016), të Kuvendit të Shqipërisë, Rezoluta e Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019) dhe parimet e Rrjetit Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit.

### Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Në përmbushje të kësaj marrëveshjeje, AIDSSH e Fondacioni **kujto.al** kanë të drejta dhe detyrime, dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të misioneve të tyre, si më poshtë:

- a. grumbullimin e të dhënave, dokumenteve dhe dëshmime për njohjen e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- b. grumbullimin e të dhënave dhe dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit;
- c. të bashkërendojnë punën kryerjen e studimeve shkencore për rolin dhe funksionin e ish-Sigurimit në shtet dhe në shoqëri, dhe për format e ndryshme të shfaqjes dhe ekzistencës së opozitës dhe kryengritjes ndaj regjimit komunist, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit;
- d. ofrimin e ndihmës studiuësve të institucioneve respektive, që dëshirojnë të bëjnë kërkime shkencore në fushat respektive që ato mbulojnë sipas ligjit;
- e. shkëmbimin e vazhdueshëm të kopjeve të periodikëve apo botimeve që publikohen nga të dy institucionet, apo materialeve shkencore dhe informative të prodhuara në formë



digjitale, me qëllim promovimin e vlerave historike, në përputhje me interesat e palëve dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi.

- f. të marrin pjesë në takime të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i kësaj marrëveshjeje.
- g. të bëjnë të disponueshme, kundrejt kërkesave, dokumente dhe materiale arkivore që i përkasin periudhës së komunizmit, me fokus veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit dhe që i nevojiten secilës palë, në funksion të veprimtarisë së punës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat;
- h. të bashkërendojnë punën për edukimin qytetar nëpërmjet garantimit të mundësive për shqyrtimin e dokumenteve të organeve të diktaturës komuniste, duke përfshirë dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të asaj periudhe; krijimin e materialeve digjitale, dëshmi, video, filma dokumentarë, etj., të cilët pasurojnë burimet për rishqyrtim të historisë dhe ridimensionim të ngjarjeve e figurave historike.
- i. Të koordinojnë hapat mes tyre për ruajtjen e materialeve digjitale të prodhuara deri më sot nga **kujto.al**, filmike të shkurtra ose të gjata, intervista me të përndjekur të ndërgjegjës e jo vetëm, në arkivin digjital të AIDSSH, duke ruajtur autorësinë e Fondacionit **kujto.al**.

## Neni 5

### Pronësia intelektuale

Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës, e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në pronësi të përbashkët e të dyja palëve.

Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe planeve vjetore të shkëmbyera reciprokisht për një periudhë kohe dy vjeçare.

Në raste të tjera të kërkesave mediatike apo studimore të Fondacionit **kujto.al** aplikohet tarifa e vendosur me ligjin funksional 45/2015 dhe me VKM nr. 93, datë 27/02/2019.

## Neni 6

### Kufizimet/Garancia

1- Palët nënkuptojnë se asnjë ndërhyrje në aktivitetet e secilës Palë nuk do të nënkuptohet si rezultat i kësaj bashkëpunimi.

2- Të dyja palët nënkuptojnë se ata nuk mund të përdorin ndonjë imazh ose përshkrime të dëshmimeve, intervistave, filmave, etj., në kuadër të projekteve të përbashkëta, për reklamim, as nuk mund t'i referohen Palës tjetër ose këtij bashkëpunimi në mënyrën që imponon miratimin ose sanksionimin nga ana e Palës tjetër ose të aktiviteve të tyre.

3- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit bie dakord që vulat e Fondacionit **kujto.al**, markat tregtare, logot, shenjat e shërbimit, emrat tregtarë të cilat mund të jenë të pranishëm në faqen e internetit të AIDSSH, nuk do të keqpërdoren nga AIDSSH në mënyrë të tillë që të nënkuptohet se aktivitetet e AIDSSH janë miratuar, sponsorizuar ose rekomanduar nga Fondacioni **kujto.al**, si dhe nuk do të përdoren si fakt për të qenë superior ndaj ndonjë produkti apo shërbimi tjetër si dhe anasjellas.



## Neni 7 Shpërndarja e materialeve

Materialet e mbledhura dhe të krijuara rishtas si rezultat i bashkëpunimit, mund të transmetohen anëmbanë botës në platforma të shumëfishta të transmetimit, nën siglën Fondacionit **kujto.al** dhe **AIDSSH**, që kanë autoritetin përfundimtar redaktues për të gjitha materialet e shpërndara për transmetim apo publikim.

Materialet e si dhe aplikimi përmes formularëve online të **Fondacionit kujto.al** dhe **AIDSSH** mund të referohen në mënyrë të ndërsjellë nga palët, në faqet e tyre zyrtare dhe zyrat përkatëse. **AIDSSH** nuk mban përgjegjësi për interpretimin e materialeve që vë në dispozicion dhe në çdo rast distancohet nga gjuha e urrejtjes në trajtimin e tyre.

## Neni 8 Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, **AIDSSH** dhe Fondacioni **kujto.al** do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacionit dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

## Neni 9 Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë Marrëveshje, bazuar në pëlqimin e tyre të ndërsjellë.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AIDSSH** dhe **Fondacioni kujto.al**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

## Neni 10 Mirëbesimi

1. **AIDSSH** dhe **Fondacioni kujto.al** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.
3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis Palëve.



**Neni 11**  
**Afati i marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

**Neni 12**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në depozitohen në **Fondacionin kujto.al – Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit**.

Për

**Autoritetin për Informimin mbi  
Dokumentet e ish Sigurimit të Shteti**

**Gentiana SULA**

  
KRYETARE



Për


**Fondacionin kujto.al  
Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit**

**Blerina GJOKA**

  
DREJTORE



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH-  
SIGURIMIT TË SHETIT**



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

Nr. 1761 Prot.

Tiranë, më 25.09.2025

**FONDACIONI "KUJTO.AL  
– ARKIVA ONLINE E  
VIKTIMAVE TË  
KOMUNIZMIT – TIRANË"**



Nr. 111 Prot.

Tiranë, më 25.09.2025

**SHTOJCË**

E lidhur sot, më datë 25.092025, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

**1. Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, (referuar më tej si "Autoriteti"/"AIDSSH"), me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, me adresë në Njësinë Administrative nr. 4, rruga "Kongresi i Manastirit", garnizoni "Skënderbej", përfaqësuar nga Gentiana Sula, kryetar i Autoritetit,

dhe

**2. Fondacionit "kujto.al – Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit – Tiranë"** (referuar më tej si "Fondacioni"), me sesli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, me adresë rruga "Kajo Karafili", Tiranë, përfaqësuar nga Blerina Gjoka, drejtor i Fondacionit.

Palët janë marrë vesh se, për të përmirësuar bashkëpunimin midis tyre, i cili është lidhur që prej marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit, lidhur më datë 13.10.2019 në Tiranë, me Nr. 1573 Prot. (të Autoritetit) dhe Nr. 01 Prot. (të Fondacionit), në kuadër të propozimit të paraqitur në thirrjen për projekte të Bashkimit Evropian: EuropeAid/184906/DD/ACT/ – "Human Rights and Democracy JAD.1162421 dhe JAG.SUM.1964038 (alokimi 2024), Lot 2 – Transitional Justice and Democratic Culture", të nënshkruajnë këtë shtojcë, të cilin marrin përsipër ta zbatojnë duke respektuar dispozitat e shprehura si më poshtë:

**Neni 1  
Qëllimi i shtojcës**

Shtojca ka për qëllim përcaktimin e rolit dhe të përgjegjësive të palëve nënshkruese të marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit, lidhur më datë 13.10.2019 në Tiranë, me Nr. 1573 Prot. (të Autoritetit) dhe Nr. 01 Prot. (të Fondacionit), në funksion të implementimit të propozimit të paraqitur në thirrjen për projekte të Bashkimit Evropian: EuropeAid/184906/DD/ACT/ – "Human Rights and Democracy JAD.1162421 dhe

JAG.SUM.1964038 (alokimi 2024), Lot 2 – Transitional Justice and Democratic Culture” (referuar më tej si “Projekti”).

## **Neni 2** **Baza ligjore**

Shtojca lidhet duke u bazuar në nenin 9/1 të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 93, datë 27.02.2019, “Për Përcaktimin e Tarifave dhe të Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”; Nenin 17 të “Rregullores Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nr. 96, datë 12.02.2024.

## **Neni 3** **Objektivat e përbashkëta**

Palët dakordësohen që në zbatim të qëllimit të kësaj shtojce dhe zbatimit të Projektit:

- a) Të forcojnë transparencën dhe aksesin e publikut në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- b) Të rrisin ndërgjegjësimin dhe edukimin qytetar mbi të shkuarën komuniste dhe dimensionet e saj represive mbi artin, kulturën dhe intelektualët;
- c) Të mundësojnë përballjen publike të dëshmisë personale me dokumentin arkivor, si akt simbolik i drejtësisë tranzicionale, brenda parashikimeve të legjislaconit të zbatueshëm;
- d) Të krijojnë produkte multimediale (artikuj, video dëshmi, “storytelling”, ekspozita, performanca dokumentare, platformë digjitale, etj.), të cilat do të promovohen në platformat e të dy institucioneve.

## **Neni 4** **Përgjegjësitë e Autoritetit**

Autoriteti merr përsipër që, në kuadrin e Projektit, të:

- a) Mundësojë që dosjet e gjendura në fondin e arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit, gjithmonë brenda kuadrit ligjor të zbatueshëm, të jenë objekt i studimeve dhe punës hulumtuese të gazetarëve, kërkuesve dhe studiuesve të autorizuar nga Fondacioni;
- b) Mbështesë gazetarët, studiuesit dhe kërkuesit e përfshirë në Projekt me ekspertizë institucionale dhe këshillim profesional prej stafit të vetë;
- c) Vërë në dispozicion hapësira për aktivitete të përbashkëta që kryhen në kuadër të Projektit në fjalë (ekspozita, “workshop”-e, tryeza diskutimi, etj.).

## **Neni 5** **Përgjegjësitë e Fondacionit**

Fondacioni, merr përsipër që, në kuadrin e Projektit, të:

- a) Koordinojë punën kërkimore dhe gazetareske për krijimin e materialeve mediatike të bazuara mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, të tilla si: artikuj, profile të përndjekurish, video-dëshmi, “*video reels*”, etj.;
- b) Organizojë 1 “*workshop*” dhe trajnim me gazetarë të rinj dhe kërkues për trajtimin profesional të dosjeve, duke pasur në vëmendje respektimin e bazës ligjore dhe rregullatore, si dhe të metodologjisë zyrtare të miratuar dhe zbatuar prej Autoritetit për kërkuesit që janë në cilësitë e medias apo studiuesit;
- c) Zhvillojë dhe publikojë analiza/investigime mbi qasjen publike në dosje dhe përgjegjësinë institucionale;
- d) Organizojë 1 ekspozitë publike me dosje, fotografi, dëshmi dhe elementë multimedialë, si dhe nëse arrihet mundësia, prezantimi i një dokumentari në mjediset e Autoritetit;
- e) Të dhurojë në platformën e Autoritetit, “Mediateka”, e cila është planifikuar të krijohet dhe të bëhet funksionale në vitin 2025-2026, por jo vetëm, skedat me profilet e të zhdukurve/ekzekutuarve (foto+jetëshkrim) në qarkun Shkodër në kuadër të aktivitetit “Tingujt e Kujtesës”, një koncert memorial në nderim të viktimave të komunizmit që do të mbahet pranë lumit ku pushkatoheshin dhe më pas varroseshin kundërshtarët politikë të regjimit. Këto produkte do të përdoren gjithashtu edhe prej Drejtorisë së Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur në AIDSSH, për qëllime të realizimit të objektit të punës së tyre. Gjithmonë, materialet e dhuruara për “Mediatekën”, do të kalojnë në kontroll ligjor dhe etik nga AIDSSH-ja, përpara publikimit sipas parashikimeve ligjore;
- f) Të vendosë në përdorim dhe të garantojë të drejtën e përdorimit të Autoritetit, për të përdorur për aktivitete, për të publikuar apo për të mbajtur në administrim të tijin prodhimet mediatike që do realizohen si produkt i projektit ‘observatori i dosjeve’, i cili do të angazhojë gazetarë dhe kërkues të rinj në studimin e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, e konkretisht do të arrihen:
  - 20 artikuj/profile të denuarish dhe të persekutuarish, bazuar mbi dosjet e studiuara;
  - 10 video-dëshmi të gjata;
  - 3 dokumentarë nga 15 minuta;
  - Të paktën 150 skeda me profilet e të zhdukurve në qarkun Shkodër, foto dhe jetëshkrim, materiale që do të përdoren për koncertin “Tingujt e Kujtesës”;
  - 20 deri 30 “*video-reels*”, që do të realizohen si produkt i punës me dosjet dhe dëshmitë e mbledhura.
- g) Të garantojë që Autoriteti nuk do të ketë asnjë detyrim, përgjegjësi apo kosto financiare në kuadër të Projektit;
- h) Nëse është e mundur, dhe palët merren vesh, të sigurojë dhe të ofrojë mbështetjen për të zhvilluar më shumë veprimtari dhe të prodhojë më shumë produkte sesa janë parashikuar në këtë nen, në varësi të ecurisë së projektit.

## **Përgjegjësitë e të dyja palëve**

1. Palët marrin përsipër të garantojnë, që në publikimin e materialeve të prodhuara nga Projekti të citohen në mënyrë të dukshme, sipas rregullave dhe përcaktimeve të praktikës përkatëse të secilit, autorësia e dhuruesve/kontributit përkatës, si dhe logo e secilit, duke cituar edhe Projektin, si kuadri në të cilin u arritën materialet e prodhuara.
2. Palët marrin përsipër vënien në dispozicion të materialeve mediatike të prodhuara në kuadër të Projektit, me qëllim për publikim të përbashkët në mediumet përkatëse që kanë.
3. Palët do të sigurojnë shpërndarje dhe komunikim mediatik të produkteve të Projektit.
4. Në lidhje me parimet etike të punës, secila nga palët është e ndërgjegjshme, që në kontekstin e marrëveshjeve të Autoritetit me subjekte si Fondacioni dhe partnerë të tjerë në fushat e kërkimit shkencor, mediatik dhe edukimit qytetar, ku përfshihet edhe mbledhja e këndvështrimeve të familjeve të prekura nga dosjet arkivore, zhvillimi i parimeve etike të bashkëpunimit është padyshim me rëndësi thelbësore për të garantuar një proces të drejtë, të ndjeshëm dhe të qëndrueshëm. Këto parime, të frymëzuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (që vendos shtetin e së drejtës, demokratik dhe social, me vlera universale si toleranca fetare, paqja dhe harmonia shoqërore), Rezolutat e Kuvendit për dënimin e krimeve të komunizmit (si ajo e vitit 2006 për dënimin e krimeve të regjimit dhe ajo e vitit 2016 për krimet ndaj klerit), qëndrimet e Parlamentit Evropian për kujtesën evropiane (duke theksuar nevojën për vlerësimin e krimeve totalitare komuniste dhe fashiste si kusht për integrimin evropian dhe ruajtjen e paqes) dhe aspiratat për një rend demokratik me vlera perëndimore, synojnë të evitojnë protagonizmin individual ose institucional, dhe mbi të gjitha të promovojnë pajtimin shoqëror, harmoninë fetare dhe fqinjësinë e mirë. Rrjedhimisht, nisur prej këtyre vlerave të patjetërsueshme, palët në kuadër të bashkëpunimit, do të fokusohen në respektin e nevojshëm ndaj viktimave të sistemeve totalitare (si ish-regjimi komunist) dhe familjeve të tyre, duke i vendosur ato në qendër të procesit, si dhe në etikën e përdorimit të imazheve dhe narrativave për moshat e reja.

### **Neni 7**

#### **Të drejtat e shfrytëzimit dhe pronësia intelektuale**

1. Të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të dokumenteve dhe të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të organeve të diktaturës komuniste të periudhës kohore 29 nëntor 1944-2 korrik 1991 (“Materialet e Autoritetit”), të cilat zotërohen nga Autoriteti, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, janë në pronësi të vetme të Autoritetit.
2. Të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të dokumenteve dhe të materialeve përkatëse (“Materialet e Fondacionit”), të cilat zotërohen nga Fondacioni në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, janë në pronësi të vetme të Fondacionit.
3. Të gjitha prodhimet dhe pronat intelektuale, të cilat krijohen si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi dhe në kuadrin e veprimtarive që rrjedhin prej tij, me kontributin e të dyja

palëve, do të jenë në pronësi të të dy institucioneve dhe do të shfaqen e do të komunikohen te palë të treta ose te publiku, në çfarëdo forme komunikimi dhe transmetimi, përherë duke përmendur kontributin e të dyja palëve. Ky parashikim do të vlejë përherë dhe i shtrin efektet e tij detyruese mbi palët edhe në rast se kjo marrëveshje zgjidhet.

## **Neni 8**

### **Rezultatet e pritshme**

Nga shtojca, si dhe prej materializimit të Projektit, palët nënshkruese presin që të arrihet:

- a) Krijimi i një fondi të përbashkët multimedial (“Mediateka”), i cili do t’i dhurohet Autoritetit dhe që do të jetë i aksesueshëm publikisht;
- b) Rritja e transparencës dhe e aksesit të publikut në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, brenda mundësive që ofrohen nga legjislacioni i zbatueshëm për to;
- c) Promovimi i dialogut shoqëror përmes ekspozitave dhe performancave dokumentare;
- d) Fuqizimi i brezit të ri të gazetarëve dhe studiuesve për të trajtuar temat e së shkuarës komuniste.

## **Neni 9**

### **Forca madhore**

1. Moskryerja apo kryerja me vonesë nga ana e secilës palë të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj shtojce nuk do të konsiderohet shkelje e përcaktimeve të tij, nëse një mospërbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërsëdrejti për shkak të ndonjë ngjarjeje të “Forcës Madhore”.

2. Për qëllime të këtij neni, “Ngjarje e Forcës Madhore” ka kuptimin e ngjarjes ose situatës që shkon përtej kontrollit të secilës prej palëve, e cila nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga secila palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen aspak vetëm në luftëra ose revolucione, zjarre, përmbytje, epidemi/pandemi, kufizime të karantinës, fatkeqësi natyrore, embargo të mallrave, etj.

3. Nëse ndodh ngjarja e Forcës Madhore, pala e prekur nga ndikimi i saj ka detyrimin që të njoftojë sa më parë që të jetë e mundur palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga pala tjetër me shkrim, pala e prekur do të vazhdojë të kryejë dhe përmbushë detyrimet e saj sipas marrëveshjes për aq sa është e arsyeshme dhe e aplikueshme, si dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen apo ndikohen nga ngjarja e Forcës Madhore.

4. Me të përfunduar gjendja dhe ndikimet që mund të shtrihen edhe pas përfundimit të ngjarjes së Forcës Madhore, pala e cila ishte prekur nga ky ndikim do të vijojë me përmbushjen e detyrimeve që i takojnë sipas kësaj marrëveshjeje njëjloj si përpara ndodhisë së ngjarjes së Forcës Madhore.

## **Neni 10**

## Dispozita të Përgjithshme

1. Kjo shtojcë është pjesë integrale e marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit, lidhur më datë 13.10.2019 në Tiranë, me Nr. 1573 Prot. (të Autoritetit) dhe Nr. 01 Prot. (të Fondacionit).
2. Të gjitha dispozitat e marrëveshjes ekzistuese mbeten në fuqi dhe aplikohen edhe në këtë Projekt, përveçse kur specifikohen ndryshe nga kjo shtojcë.
3. Kjo shtojcë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në zbatim për periudhën e Projektit sipas afateve të përcaktuara nga kontrata e financimit të Delegacionit të BE-së në Tiranë.
4. Shtojca nënshkruhet në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe dy të tjera do të depozitohen në Fondacionin “kujto.al – Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit – Tiranë”.

### Neni 11

#### Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Shtojca hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Shtojca nënshkruhet në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe dy të tjera do të depozitohen në Fondacionin “kujto.al – Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit – Tiranë”.

PËR

**AUTORITETIN PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH-  
SIGURIMIT TË SHETIT**

KRYETARI  
  
Gentiana Sula  



PËR

**FONDACIONIN “KUJTO.AL –  
ARKIVA ONLINE E VIKTIMAVE  
TË KOMUNIZMIT – TIRANË”**

DREJTORI ORGANIZATIV

  
Blerina Gjoka  


**AUTORITETI PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH-  
SIGURIMIT TË SHETIT**



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

Nr. 1046 Prot.

Tiranë, më 11.05.2026

**FONDACIONI "KUJTO.AL  
– ARKIVA ONLINE E  
VIKTIMAVE TË  
KOMUNIZMIT – TIRANË"**

 **kujto.al**

Nr. 11 Prot.

Tiranë, më 11.05.2026

## **SHTOJCË**

Kjo shtojcë ("Amendim") lidhet dhe është pjesë integrale e Memorandunit të Mirëkuptimit të lidhur ndërmjet palëve më datë **13.10.2019** në Tiranë si dhe shtojcës së nënshkruar ndërmjet palëve më datë **25.09.2025**.

Kjo shtojcë lidhet sot, më datë 11 / 05 / 2026, në Tiranë, ndërmjet:

1. **Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)**, me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari; dhe
2. **Fondacionit "Kujto.al – Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit – Tiranë"**, me seli në Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Organizativ;

(referuar më tej si "Palët").

Në vijim të diskutimeve ndërmjet palëve dhe në funksion të implementimit të Projektit, palët bien dakord që në Memorandumin e Mirëkuptimit të përfshihen sqarimet e mëposhtme, me qëllim garantimin e një kuptimi të përbashkët mbi rolet, përgjegjësitë dhe mënyrën e bashkëpunimit institucional.

### **Neni 1**

#### **Zbatimi i udhëzuesve institucionalë të AIDSSH-së**

- 1.1 Palët bien dakord që në realizimin e aktiviteteve që lidhen me Mediatekën dhe dëshmitë e gjalla të merren në konsideratë udhëzuesit përkatës të AIDSSH-së, si në aspektin e formës ashtu edhe të procedurës, në përputhje me kuadrin ligjor dhe etik në fuqi.
- 1.2 Produktet mediatike të realizuara nga Fondacioni në kuadër të Projektit do të mbeten të bazuara në standarde profesionale mediatike dhe kërkimore, të shkruara në një gjuhë të kuptueshme për publikun e gjerë.

1.3 Për të mundësuar harmonizimin e produkteve me kërkesat e Mediatekës, AIDSSH do të vërë në dispozicion modele referuese ose standarde orientuese mbi mënyrën e strukturimit dhe përshtatjes së materialeve për publikim në platformë.

## **Neni 2**

### **Përzgjedhja e studiuesve dhe bashkëpunëtorëve të projektit**

2.1 Palët konfirmojnë se çdo organizatë ruan autonominë e saj institucionale në përzgjedhjen dhe kontraktimin e stafit të vet.

2.2 Në frymën e bashkëpunimit, palët bien dakord që për studiuesit që do të angazhohen pranë AIDSSH-së në funksion të Projektit, të aplikohet një mekanizëm përzgjedhjeje i përbashkët konsultativ, i cili do të përfshijë:

- hapjen e thirrjeve publike nga Fondacioni, sipas detyrimeve të projektit;
- shkëmbimin e sugjerimeve nga AIDSSH lidhur me përshtatshmërinë profesionale të kandidatëve;
- respektimin e standardeve të transparencës dhe meritokracisë.

## **Neni 3**

### **Mekanizmat e koordinimit dhe Steering Committee**

3.1 Palët bien dakord për krijimin e një grupi pune të përbashkët (Steering Committee) me përfaqësues të të dy institucioneve, i cili do të ketë rol koordinues dhe këshillues për ecurinë e bashkëpunimit.

3.2 Nga AIDSSH-ja, pjesëmarrës në këtë grup të përbashkët pune, do të jenë 3 përfaqësues, ku 2 do të jenë nga Drejtoria për Marrëdhëniet Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, dhe 1 nga grupi i punës i AIDSSH-së për Mediatekën.

3.3 Steering Committee do të mbledhet në intervale kohore çdo 4 deri në 6 muaj, ose sipas nevojës së projektit, për:

- shqyrtimin e progresit të aktiviteteve;
- koordinimin institucional;
- adresimin e çështjeve procedurale apo metodologjike.

3.4 Takimet mund të zhvillohen fizikisht ose online dhe do të shoqërohen me procesverbal të shkurtër informues.

## **Neni 4**

### **Qëllimi i amendimit**

4.1 Ky amendim synon qartësimin e mënyrës së bashkëpunimit ndërinstitucional, pa ndryshuar detyrimet ligjore dhe kontraktuale ekzistuese të palëve sipas Memorandumit në fuqi dhe kontratës së financimit të Projektit.

4.2 Të gjitha dispozitat e tjera të Memorandumit të Mirëkuptimit mbeten të pandryshuara dhe në fuqi të plotë.

## **Neni 5**

### **Dispozita përfundimtare**

5.1 Ky amendim është pjesë integrale e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe shtojcës ekzistuese dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët.

5.2 Të gjitha dispozitat e tjera të Memorandumit dhe shtojcave të mëparshme mbeten të pandryshuara dhe në fuqi të plotë.

**PËR  
ARUTORITETIN PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH-  
SIGURIMIT TË SHETETIT**

**KRYETARI**

**Gentiana Sula**



**PËR  
FONDACIONIN "KUJTO,AL"  
ARKIVA ONLINE E VIKTIMAVE  
TË KOMUNIZMIT - TIRANË**

**DREJTORI ORGANIZATIV**

**Blerina Gjoka**

